

URDHËR
Nr. 164, datë 12.3.2020

**PËR MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, LOKALEVE, FAST FOOD DHE
KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT AKOMODUESE
QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT**

(ndryshuar me urdhrin nr.217, datë 1.4.2020)

(i përditësuar)

Në zbatim të nenit 7, pika 4 të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, në të gjithë vendin, *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.*
 2. Përfundim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.
 3. Përdorimi i shërbimeve të bareve dhe restoranteve në strukturat akomoduese vetëm për qytetarët e akomoduar në strukturën akomoduese përkatëse, *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.*
 4. Strukturat akomoduese ndalohen të ofrojnë shërbim bar dhe restorant për qytetarë që nuk janë klientë të strukturës akomoduese, *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.*
 5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
 6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**